



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:211634

Datë: 10.08.2022

Numri i dokumentit: 03500074

C.nr.235/2019

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha, si gjyqtar individual, duke vendosur në çështjen juridike të paditësve D. H. dhe A. A. nga Komuna e Kaçanikut të cilët me autorizim i përfaqëson Avokati B. B. nga Prishtina, me adresë rruga “...” ... 5 Hyrja 1 nr.11, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve K.S “...” me seli në Prishtinë, me adresë Rr. “...” nr., për çështjen kontestuese kompenzim i dëmit, në seancën kryesore të mbajtur me dt.10.08.2022, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa më date 12.09.2022 bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T G J Y K I M I

I. MIRATOHET, pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve D. H. dhe A. A. nga Komuna e Kaçanikut dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve K.S “...” me seli në Prishtinë, me adresë Rr. “...” nr., që paditësve në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 23.06.2019, t’ia paguaj edhe atë:

a. Paditësit D. H.:

Dëmin material dhe jo material:

➤ Për dhimbje trupore –fizike shumën prej	4.800.00€
➤ Për frikën e shkaktuar shumën prej	3.360,00€
➤ Për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë shumën prej.....	400.00€
➤ për dhimbje shpirtërore si pasojë e zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallen 13.52%, shumën prej.....	9,000.00€
➤ Për shëmtimin trupor në shkallë të mesme shumën prej.....	5.000.00€
➤ Për ushqimi e përforcuar shumën prej	400,00€
➤ Në emër të shpenzimeve të shërimit (kuponë fiskale) shumën prej	119.00€
Gjithsej shumën.....	23.079.00€

b. Padiësit A. A.:

Dëmin material dhe jo material:

➤ Për dhimbje trupore –fizike shumën prej	1.300,00€
Për frikën e shkaktuar shumën prej	910.00€
➤ Për shëmtimin trupor në shkallë të mesme shumën prej	3.800 €
➤ Për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë shumën prej.....	220.00€
➤ Për ushqimin e përforcuar shumën prej	220.00€

**Gjithsej
shumën.....6.450,00€**

Të gjitha këto shuma me kamatë vjetore prej 8% duke filluar prej dt 10.08.2022 e gjerë në pagesën definitive.

II. REFUZOHET pjesa e kërkesëpasdisë përtej shumave nga pika një e dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë: për padiësin **D. H.** në emër të kompensimit për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej **3.200** Euro, në emër të kompensimit për frikën e përjetuar shumen prej

2640 Euro, në emër të ndihmës dhe kujdesin e personit të tretë shumën prej **200**Euro, në emër të shëmtimit trupor shumën prej **3.000** Eur, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej **6,000.00** Euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej **200**Euro dhe në emër të shërimit klimatik shumën prej **600**Euro, ndërsa për paditësin **A. A.**, në emër të kompensimit për dhimbjen e përjetuara fizike shumën prej **1.700** Euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej **1.090** Euro, në emër të shëmtimit shumën prej **4.200** Euro, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej **110** Euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej **110** Euro dhe në emër të shërimit klimatik shumën prej **600**Euro.

III. **DETYROHET** e paditura që paditësve t'ia paguaj shumat e gjykuara në pikën I. të këtij dispozitivi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.514.40, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

IV. **DETYROHEN** paditësit që të paguajnë shumën prej 100.00€ në emër të taksës për padi, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur padi në gjykatë më dt.25.09.2019 duke theksuar se me datë 23.06.2019 rreth orës 01:37 min. në rrugën “Ismajl Raka” Komuna e Kaçanikut, është shkaktuar aksident trafiku ku lëndime trupore kanë pësuar paditësit D. H. dhe A. A. duke shtuar se aksidenti ka ndodhur me fajin e vozitësit të automjetit të njësisë A- VW ... me targa të regjistrimit ..., të cilin e ngiste L. D., i cili ishte duke lëvizur nga rruga “...” në drejtim të rrugës “Ismajl Raka”, ashtu që me të arritur në udhëkryq nuk ndalet në shenjën “...” dhe pa u siguruar që me këtë veprim nuk do të pengojë pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, me pjesën e majtë të anës së majtë të automjetit e godet në anën e djathtë motoçikletën të cilën e drejtonte i dëmtuari D. H., i cili lëvizte në rrugën “Ismajl Raka”, me ç'rast i shkaktohen dëme materiale në motoçikletë si dhe lëndime trupore marrin drejtuesi dhe pasagjeri në motoçikletë.

I autorizuari i paditësve edhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë në fjalën përfundimtare deklaroi: se qëndron në tërësi si në deklaratimet në padi duke e bërë precizimin e padisë lidhur

me shumtë e kërkuara për dëmin e shkaktuar nga ana e të sigurvearit të të paditurës i cili ka qenë shkaktar i aksidentit dhe për këtë e paditura mban përgjegjësi nga sigurimi i detyrueshëm nga autopërgjegjësia andaj lidhur me këtë i ka propozuar gjykatës që të aprovoj kërkespadinë e precizuar si dhe ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Shpenzimet i ka kërkuar.

E paditura sikurse me anë të përgjigjes në padi, edhe gjatë seancave gjyqësore ka theksuar se për të paditurën baza juridike e padisë është pjesërisht kontestuese, ndërsa lartësia e dëmit është tërësisht kontestuese, po ashtu gjatë fjalës përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që vendimin ta bazojë në prova materiale dhe të ketë parasysh ofertën e dhënë e cila për paditësin D. H. është 7.000€, ndërsa për paditësin A. A. është 1.500€, ku kanë konsideruar se ofertat janë të arsyeshme me natyrën e lëndimeve të cilat i kanë pësuar paditësit.

Shpenzimet i ka propozuar gjykatës të aplikohen në bazë të dispozitave të nenit 452 dhe 453 të LPK-së.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile me propozimin e palëve ndërgjyqëse e zhvilloi procedurën e provave duke e bërë leximin e këtyre provave të shkruara: Raporti i aksidentit i datës 23.06.2019, raporti i policit hetues dhe skica e vendit të ngjarjes i të njëjtës datë, fletëpagesa e dt. 26.06.2019 me numër serik 051731 dhe 051732, fatura e dt. 02.07.2019, raportet mjeksore për paditësin D. H. dhe raportet mjekësore për paditësin A. A., të pershkruara si në ekspertizën me shkrim, ekspertiza e komunikacionit nga eksperti S. B. e datës 25.03.2022 dhe konstatimi-ekspertiza mjekësore e eksperteve Dr. M. H. dhe Dr.S. B., pa pyetje dhe pa vërejtje.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të secilës veç e veç si dhe konform nenit 8 të LPK-së, dhe bindjes së lire të gjykatës, Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më dt.23.06.2019 rreth orës 01:37 në rrugën “Ismajl Raka” Komuna e Kaçanikut, ku lëndime trupore kanë pësuar paditësit D. H. dhe A. A., ky aksident ka ndodhur me fajin e vozitësit të automjetit të njësisë A- VW .. me targa të regjistrimit ..., të cilin e ngiste L. D., i cili ishte duke lëvizur nga rruga “Qamil Ilazi” në drejtim

të rrugës “Ismajl Raka”, ashtu që me të arritur në udhëkryq nuk ndalet në shenjë “...” dhe pa u siguruar që me këtë veprim nuk do të pengojë pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, me pjesën e majtë të anës së majtë të automjetit e godet në anën e djathtë motoçikletën të cilën e drejtonte i dëmtuari D. H., i cili lëvizte në rrugën “Ismajl Raka”, me ç’rast i shkaktohen dëme materiale në motoçikletë si dhe lëndime trupore marrin drejtuesi dhe pasagjeri në motoçikletë, ku si rezultat i këtyre lëndimeve paditësit kanë pësuar dhimbje fizike dhe frikë ku kanë pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë, kanë pasur nevojë për ushqim të përforcuar, kanë pësuar shëmtim trupor, ndërsa specifikisht paditësi D. H. ka pësuar edhe zvogëlim të aktivitetit jetësorë dhe përgjegjëse për mbulimin e dëmeve të tilla është e paditura, fakte këto të cilat sipas nen.173 dhe 183 të LMD-së paraqesin bazë për kompensimin e dëmit.

- Se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më dt.23.06.2019 rreth ores 01:37 në rrugën “Ismajl Raka” Komuna e Kaçanikut, këtë fakt gjykata e vërtetoi në bazë të raportit të aksidentit dhe raportit të policit hetues të dt. 23.06.2019 e fakt ky i cili nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse.

- Se aksidenti i komunikacionit është shkaktuar me fajin e vozitësit të automjetit të njesis A të pershkruar si ne raportin e aksidentit-voztësit L. D. i cili ishte i siguruar të e paditura dhe po ashtu përgjegjëse për mbulimin e dëmeve të tilla është e paditura këto fakte gjykata i vërtetoi nga raporti i aksidentit i dt. 23.06.2019 dhe nga raporti i policit hetues i te njejtës datë, si dhe faktin se ky aksident është shkaktuar me përgjegjësinë e vozitësit Liman Dardhishta gjykata e vërtetoi në bazë të Ekspertizës së komunikacionit të punuar nga eksperti S. Berisha dt.25.03.2022 i cili në faqen 4 pika 4.6 konstaton se përfundimisht L. D. është shkaktar i aksidentit, prandaj gjykata provën e marrë përmes ekspertizës së komunikacionit e ka trajtuar si provë të rëndësishme në raport me objektin e kontestit, ndërsa po ashtu kësaj prove ia ka dhënë kredibilitetin e plotë të fuqisë provuese sepse kjo provë është marrur nga personi me aftësi profesionale duke përdorur metodat profesionale të fushën së komunikacionit, andaj për gjykatën e njejtës është bindëse dhe e punuar sipas standardeve profesionale, e po ashtu ky fakt nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse.

- Se në këtë aksident paditësit pa fajin e tyre kanë pësuar lëndime trupore, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertëve Dr. M. H. ortoped- traumatolog dhe Dr. S. B. psikiatre, të cilët mendimin e kanë dhënë në formë të shkruar më dt.16.05.2022, ku kanë konstatuar se paditësi D. H. në momentin e aksidentit ka pësuar këto lëndime trupore: Thyerje

e kocës të rrezatorit (radiusit) të dorës së majtë, thyerje të kockës së ashtit mollëzor (zygomaticus) të anës së djathtë, i cili lëndim karakterizohet si lëndim i rëndë trupor, dhe paditësi A. A.ka pësuar këto lëndime trupore: plagë prerëse – shkyse në pjesën e poshtme të kofshës së djathtë afër gjurit, plagë prerëse – shkyse në pjesën e sipërme dhe të mesme të kërcirit të djathtë, i cili lëndim karakterizohet si lëndim i lehtë trupor, e të cilën ekspertizë palët ndërgjyqëse nuk e kontestuan.

a.1)Se paditësi **D. H.** ka përjetuar dhimbje fizike, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertit Dr. M.H. –ortoped- traumatolog, i cili ka konstatuar se paditësi ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaqerishte te rëndë një orë, të intenzitetit me të rëndë 4 ditë, të intensitetit të mesëm 40 ditë dhe të intensitetit të ulët ka edhe sod e kësja dite , andaj gjykata duke u nisur nga lloji i dhimbjeve, intensiteti dhe koha e zgjatjes së dhimbjeve, vendosi që shumta prej 4.800€ është në harmoni të plotë me dhimbjet e përjetuara dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

a.2) Se paditësi **D. H.** në këtë aksident ka pasur shëmtim trupor të shkallës së mesme, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertit Dr.M. H., i cili ka konstatuar se paditësi si pasojë e vrragës në pjesën e parakrahut të majtë me gjatësi 15cm dhe gjërësi 1cm, i dukshëm kohë pas kohe, sidomos në periudhat e nxehta kohore kur paditësi ekspozohet me rroba të shkurta, Pastaj si pasojë e deformimit në fytyrë në anën e djathtë të mollzës e dukshme tërë kohës e cila në pyetje eventuale se si janë shkaktuar, e rikthejnë në kujtesën e momentin të aksidentit, andaj gjykata duke u nisur nga ky fakt, ka vlerësuar se kompensimi në lartësin prej 5.000€ është në harmoni të plotë duke u bazuar edhe në praktikat tjera gjyqësore.

a.3) Se paditësi **D. H.** në këtë aksident ka përjetuar frikë, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e ekspertit të psikiatrisë Dr. S. B. Psikiatre, e cila mendimin e dha në formë të shkruar dhe konstatoi se paditësi në momentin e aksidentit ka pësuar frikë primare ne forme te frikes nga vdekja qe ka zgjatur disa sekonda sekondare të intensiteti të lartë e cila ka zgjatur për 48orë, të intensitetit te ultë që ka zgjatur 2 deri në 4 muaj, andaj gjykata duke u nisur nga lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës ka vlerësuar se kompensimi në lartësi prej 3.360.00€ është i drejt dhe adekuat për frikën e pësuar.

a.4) Se paditësi **D. H.** pas këtij aksidenti ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar ne këtë fakt gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertit mjekësorë Dr.M. H. i cili ka theksuar se

paditësi ka pasur nevoj për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 40 ditësh, andaj gjykata vlerësoi se shuma prej 400€ (duke ia llogaritur kohëzgjatjen prej 40 ditësh, nga 10€ në ditë), është në proporcion me nevojën për ushqim të përforcuar të paditësit.

a.5) Se paditësi **D. H.** ka pasur nevoj për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë si pasojë e lëndimeve të marra në aksident, këtë fakt gjykata e vërtetoi në bazë të mendimi i ekspertit mjekësorë Dr.M.H. i cili ka theksuan se paditësi ka pasur nevoj për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 40 ditësh, andaj gjykata vlerësoi se shuma prej 400€ (duke ia llogaritur kohëzgjatjen prej 40 ditësh, nga 10€ në ditë), për ti kryer aktivitetet e përditshme jetësore, andaj gjykat vendosi që të caktoj shumën prej 400 € duke konsideruar se është në proporcion real me nevojat e paditësit si dhe kërkesës së palës paditëse.

a.6) Se paditësi **D. H.** ka pasur nevojë për blerjen e barnave dhe vizitave specialiste në emër të shpenzimeve të shërimit në shumën prej 119.00€, gjykata këtë fakt e vërtetoi nga kuponët fiskal me vlerë 30.00 € i datës 01.07.2019 dhe vlerës 55.00 € i datës 05.07.2019, po ashtu nga fatura nr: ORT153592 e leshuar nga ortopedi me vlerë prej 34.00 €, gjithsej shumën e kërkuar si në precizim 119.00 €, prandaj gjykata gjeti se provat e prezentuara të kuponëve fiskal iu referohen shpenzimeve reale të paditësit.

b.1) Se paditësi **A. A.** ka përjetuar dhimbje fizike, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertit Dr.M. H. ortoped- traumatolog, i cili ka konstatuar se paditës ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaqerishte te rëndë 30 minuta, ndërsa të intenzitetit të rëndë 2 dit, të intensitetit të mesëm 22 ditë dhe të intensitetit të ulët ka edhe sod e kësja dite , andaj gjykata duke u nisur nga lloji i dhimbjeve, intensiteti dhe koha e zgjatjes së dhimbjeve, vendosi që shuma prej 1300€ është në harmoni të plotë me dhimbjet e përjetuara dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

b.2) Se paditësi **A. A.** në këtë aksident ka përjetuar frikë, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e ekspertit të psikiatrisë Dr. S. B.Psikiatre, e cila mendimin e dha në formë të shkruar dhe konstatoi se paditësi në momentin e aksidentit ka pësuar frikë primare ne forme te frikes nga vdekja qe ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensiteti të lartë e cila ka zgjatur për 48 orë, frikë sekondare të intensitetit te ultë që ka zgjatur 2 deri 3 muaj, andaj gjykata duke u nisur nga lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës ka vlerësuar se kompensimi në lartësi prej 910€ është i drejt dhe adekuat për frikën e pësuar.

b.3) Se paditësi **A. A.** pas këtij aksidenti ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në këtë fakt gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertit mjekësorë Dr.M. H. i cili ka theksuar se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 22 ditësh, andaj gjykata vlerësoi se shuma prej 220€ (duke ia llogaritur kohëzgjatjen prej 22 ditësh, nga 10€ në ditë), është në proporcion me nevojën për ushqim të përforcuar të paditësit.

b.4) Se paditësi **A. A.** ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë si pasojë e lëndimeve të marra në aksident, këtë fakt gjykata e vërtetoi në bazë të mendimi i ekspertit mjekësorë Dr.M. H. i cili ka theksuar se paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 22 ditësh, andaj gjykata vlerësoi se shuma prej 220€ (duke ia llogaritur kohëzgjatjen prej 22 ditësh, nga 10€ në ditë), për ti kryer aktivitetet e përditshme jetësore, andaj gjykat vendosi që të caktoj shumën prej 220 € duke konsideruar se është në proporcion real me nevojat e paditësit si dhe kërkesës së palës paditëse.

b.5) Se paditësi **A. A.** në këtë aksident ka pasur shëmtim trupor të shkallës së mesme, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertit Dr.M. H., i cili ka konstatuar se paditësi si pasojë e vragës në pjesën e poshtme të kofshës së djathtë me gjatësi 25cm dhe gjërsi 1-2.5cm në formë kelloidi gjysëmrrrethorë, pastaj plagës në kërcirin e djathtë me gjatësi 3-5 cm dhe gjërsi 1-2cm të dukshme kohë pas kohe sidomos në periudhat e nxehta kohore kur paditësi ekspozohet me rroba të shkurta, duke bërë që në pyetje eventuale se si i janë shkaktuar e rikthejnë në kujtesën në momentin e aksidentit, andaj gjykata duke u nisur nga ky fakt, ka vlerësuar se kompensimi në lartësin prej 3.800€ është në harmoni të plotë duke u bazuar edhe në praktikat tjera gjyqësore.

Gjykata e refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve mbi shumën e miratuar dhe atë për paditësit **D. H.** në emër të kompensimit për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej **3.200** Euro, në emër të kompensimit për frikën e përjetuar shumën prej **2640** Euro, në emër të ndihmës dhe kujdesin e personit të tretë shumën prej **200**Euro, në emër të shëmtimit trupor shumën prej **3.000** Eur, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej **6,000.00** Euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej **200**Euro dhe në emër të shërimit klimatik shumën prej **600**Euro, ndërsa për paditësin **A. A.**, në emër të kompensimit për dhimbjen e përjetuara fizike shumën prej **1.700** Euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej **1.090** Euro, në emër të shëmtimit shumën prej **4.200** Euro, në emër të ndihmës dhe

kujdesit të huaj shumë prej **110** Euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej **110** Euro dhe në emër të shërimit klimatik shumë prej **600** Euro, pasi që shumat e kërkuara si në precizimin e kërkesëpadisë ishin shuma tepër të larta e të cilat nuk përkojnë me asnjë praktikë gjyqësore dhe nuk janë në harmoni me kriteret e kompanive të sigurimit këtë konkluzion gjykata e bazoi duke marr parasysh llojin e lëndimit të paditësve dhimbjet e përjetuara si dhe pasojat tjera të aksidentit, e tërë kjo duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të mjekësisë si dhe krahasimin e praktikave gjyqësore lidhur me lëndimet dhe pasojat e ngjashme të këtij karakteri, ndërsa për shumat nga **600.00** Euro në emër të shërimit klimatik gjykata i refuzoi pjesën e kërkesëpadisë për këtë kategori të kompensimit për të dy kërkesat e paditësve, sepse nuk janë ofruar prova mbi bazën e të cilave do të provoheshin shpenzimet e bëra për qëllime të këtij kompensimi të pretenduar, e duke u bazuar në nen.323 të LPK-së, në vlerësimin e lire ka ardhur në përfundim se shumat e gjykuara në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë shuma reale dhe në përpjesëtim me dëmin e theksuar nga paditësi për shkak të dhimbjeve të përjetuara fizike.

Gjykata i analizoi theksimet e të autorizuarit të paditësve, i cili i propozoj gjykatës që të njejtat ti aprovoj në tërësi si të bazuara ku po ashtu ka kërkuar që paditësve shumat e gjykuara ti gjykohen me kamat ligjore – ndëshkuese prej 12% nga dita e paraqitjes së padisë për kompensim dëmi të dt. 19.09.2019, e deri në pagesën definitive, e këtyre theksimeve gjykata pjesërisht ua dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes morri për bazë theksimet e të autorizuarit të t'paditurës me anë të përgjigjes në padi dhe në seancën gjyqësore i cili ka theksuar se për të paditurën baza juridike e padisë është pjesërisht kontestuese, ndërsa lartësia e dëmit është tërësisht kontestuese, po ashtu gjatë fjalës përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që vendimin ta bazojë në prova materiale dhe të ketë parasysh ofertën e dhënë e ku kanë konsideruar se ofertat janë të arsyeshme me natyrën e lëndimeve të cilat i kanë pësuar paditësit, këto theksime gjykata i vlerësoi me kujdes, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u theksua më lart u vërtetua se paditësit si pasojë e lëndimeve të shkaktuara në aksidentin e cekur më lart, kanë pësuar dëm material dhe jo material në shumat e caktuara dhe përgjegjësinë për këtë dëm në rastin konkret e mban e paditura, nga baza e auto përgjegjësiive respektivisht në mbështetje të nenit 9 dhe 10 të LSDA-së, si dhe duke u bazuar në nenin 136, nenit 173 par.1, 179 dhe neni 183 të LMD-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit, Gjykata me kërkesën e paditësit dhe në bazë të nen.382 të LMD-së, e detyroi të paditurin që paditësit në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën prej 8% pasi që me Ligjin mbi marrëdhëniet e Detyrimeve në kuptim të detyrimit që rrjedh nga dëmi i shkaktuar si dhe kamatën lidhur me këtë rast e llogariti nga data 10.08.2022 prej datës kur është bërë administrimi i provave dhe gjykata është bindur se ekziston dëmi i tillë, e deri në pagesën definitive, po ashtu vendimin mbi kamatën gjykata e mbështeti edhe në bazë të Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2022 i datës 02.12.2020 gjegjësisht pika XV e këtij Mendimi juridik.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditësit të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **1.514.40€** edhe atë: (**156.00€** për përpilimin e padisë, **608.40€** për 3 përfaqësime nga ana e avokatit, **500.00€** për ekspertizën e ortopedit dhe psikiatrit, **150.00€** për përpilimin e ekspertizes se komunikacionit dhe shumën prej **100.00€** në emër të taksës për padi), të parapara sipas udhëzimit administrativ nr.01/2017 të Këshillit Gjyqësorë. Gjykata gjeti se kërkesa për shpenzime për daljen nga zyra dhe të udhëtimit janë të pabazuara dhe nuk kanë mbështetje ligjore, në këtë drejtim janë në kundërshtim me nenin 453 të LPK-së sepse gjykata do ti njeh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për gjykim, prandaj kërkesa e të autorizuarit të paditësve është e paarsyeshme dhe në asnjë rrethanë nuk mund të ngarkohet pala e paditur që ti paguaj transportin dhe largimin nga zyra e tij për interesat e tij si avokat. Gjykata vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1,453 dhe 449 të LPK-së.

Nga sa u theksua më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK

Departamenti Civil

C .nr.235/2019 prej dt.10.08.2022

GJYQTARI:

Burhan BERISHA

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së tij, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë përmes

Numri i lëndës: 2019:211634
Datë: 10.08.2022
Numri i dokumentit: 03500074

kësaj gjykatë në kopje të mjaftueshme.